



BIBLIOTEKA

854-1
V24.

PIRRO
VISARI



KORBI POLITIKAN



fabula

81H-1
n74.

PIRRO VISARI

**Korbi
politikan**



Fabula -

«Korbi politikan» është libri i katër i P. Visarit. Në konkursin kombëtar të 45 vjetorit të Çlirimit të Atdhdeut, ka marrë çmim të aytë për vëllimin me fabula «Këmborë për të gjithë».

Gjithashtu mjaft krijime të tjera si «Reformat e luanit» etj., janë vlerësuar me çmime në konkurset tradicionale të revistës «Hosteni».


Redaktorë:

SKËNDER DEMOLLI
PETRAQ KITA

Piktor:

ANASTAS KOSTANDINI

KLUBI I SHKRIMTARËVE
«BOTA E RE»



VOKALICA NE MESNATE

(*Fabula*)

K E Q V E N D O S J E

Bufi, si shef kuadri mjaft kompetent,
ariun e ngathët e vendosi postier.

Dhe lepurin veshgjatë pa u menduar fort
i është fletën e punës për hamall në port.

Ankesat, kuptohet, po vinin si breshër:
oriu i çonte letrat me një muaj vonesë.

Ndërsa lepuri mezi hiqej zvarrë në port,
më të shumtën e kohës qe me raport..

KORBI POLITIKAN

KEQAFEN DQOSHE

MAJMUNI NË PEMË

Lodronte majmuni në barin e gjelbër,
s'u ngop e vendosi të ngjitej në pemë.

Dhe kapej në degë me dhëmbë e khetër,
trungu rrëzonte gjethet e vjetër...

Elefandi e shihte me nge dhe kureshtje,
pastaj tundi feçkën, foli me vete:

— Sa më lart të ngjitesh në pemë, o mik,
prapanikja të del, më tepër aqik.

KORRI POUTKAN
PIRRO VISARI

MARRËZIA E PULËS

Një pulë e urtë sa më s'ka,
ngujuar mbi vezë në kotec,
me lafshën kapitur, mbi tra,
një gjel hijerëndë kish shef.

Dhe zëri s'i ndihej gjëkundi,
veç çastin kur shpejt bënte vezën.
- Ç'më duhet, - thoshte, - debati,
se shefi ta bëka të zezen...

Kështu e shtyu me vite.
Dikur i shkrepi në kokë:
- A s'dola njëherë shëtitje!
Shkojmë apo jo në Evropë!

KORBI POLITIKAN

Dhe ecte në rrugë me qibër,
dhe kokën s'ë kthente nga pas.
Një rrul i hipi përsipër,
e bëri si petull me vaj.

Pa foli e gjora, së fundi;
- Ç'mu desh, moj motra, ky qejf?!
Të gjallë në dhe më nguli,
ky qënka, ç'na qënka pér shef!

HAKIMIKA E GOMARINI

BISHTI I DHISE

Dhia i pa bishtin deles njëherë,
kur i mbeti ngritur diku në një ferrë.

- Pu, pu, ç'më panë sytë! Skandal i padëgjuar!
Ti qënke se ç'qënke, thëngjill i mbuluar!

Delja blegériu: - Pusho, moj gjynahqare!
Ti bishtin e ke dredhur, mes ditës, ashiqare.

Mbi gur kërceu dhia: - Ç'akuzë pa lezet!
Unë jam artiste dhe merrem me balet.

KORBI POLITIKAN

HAKMARRJA E GOMARIT

Luani, njëherë,
u sëmur rëndë.
Shtatë palë ethe,
e dridhin nga koka në këmbët.

Gjithë kafshët e pyllit,
i shkuan vizitë, varg.
Një gomar, u nis edhe ai

pas berihajt...

Kur pa luanin e leqendisur,
mendoi papritur:
me ç'tregojnë bathët
s'e ka të gjatë

ky tiran pa shpirt,

Gjithë jetën kam rrojtur

me frikën e tij.

Bile dhe në dasmë kur më ftoi,
(ku shkova pa asnjë dëshirë)
më vuri të mbaja ujë

për mysafirët...

Përse të mos ia kthej

me të njëjtën monedhë?

...Dhe ngriti bishtin,

e ngriti këmbët: